



D.P.K.24.T
1.3.2021


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE KORÇË

Nr. 1068/2 Prot.

Lënda: Kthim përgjigje.

Korçë, më 25.2.2021

BASHKISË MALIQ
Z. GËZIM TOPÇIU
KRYETAR



Në përgjigje të tuajës nr. 1063/1 prot, datë 17.02.2021, administruar me tonën nr.1068/1 prot, datë 19.02.2021 në lidhje me mungesën e dokumentacionit në afishimi i kërkuar për subjektin Ersilda Xhafer Pëllumbi ju bëjmë me dije se:

Ashtu si ju është cituar në shkresën tonë nr. 1068 prot, datë 11.02.2021 në zbatim të pikës 31 dhe 32 të VKM-së 1040/2020 ku parashikohet që “ Lista e subjekteve përfituese të ndërtimeve të legalizuara, shoqëruar me të dhënat e pasurive, si adresa , zona kadastrale, numri i pasurisë publikohet në ambientet e ASHK-së, pranë njësisë së vetqeverisjes vendore, si dhe në faqen zyrtare të internetit të ASHK-së” dhe “ Subjektet e interesuara në përputhje me afatet e përcaktuara në dispozitat e Kodit të Proçedurave Administrative, kanë të drejtë të paraqesin ankim administrativ për vendimin e legalizimit , pranë strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së”, për sa më sipër në ambientet e Institucionit tuaj afishohet lista e subjekteve përfituese të ndërtimeve të legalizuara shoqëruar me të dhënat e pasurisë dhe jo dokumentacioni teknik (Genplan), për sa më sipër nuk ka mangësi dokumentacioni në shkresën e deleguar.

Ju rikujtojmë edhe njëherë që në rast paraqitje të subjekteve të interesuara , orientimin e tyre që në përputhje me afatet e përcaktuara në dispozitat e Kodit të Proçedurave Administrative, kanë të drejtë të paraqesin ankim administrativ për vendimin e legalizimit , pranë strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,



Nr.24/1 Prot
Bt. 02.03.2021